ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle / me Zgjedhje në Arsimin e Mesëm të Lartë

"EDUKIMI I TË RINJVE PËR NDËRTIMIN E PAQES DHE TRANSFORMIMIN E KONFLIKTIT"

Koordinator: Albana Markja, Evis Mastori

www.ascap.edu.al

2026

1. HYRJE

Moduli “Edukimi i të rinjve për ndërtimin e paqes dhe transformimin e konfliktit” ndërtohet mbi parimet e edukimit për paqen, të drejtave të njeriut, pjesëmarrjes rinore dhe angazhimit qytetar etj. Ai zhvillohet në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë, si dhe me parimet dhe angazhimet ndërkombëtare që nxisin përfshirjen e të rinjve në ndërtimin e paqes dhe forcimin e sigurisë, përfshirë edhe Rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për “Rininë, Paqen dhe Sigurinë”.

Nëpërmjet këtij moduli synohet formimi i të rinjve si qytetarë të ndërgjegjshëm, kritikë dhe të aftë për të kontribuar në një shoqëri demokratike, gjithëpërfshirëse dhe paqësore, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Qasja e modulit integron zhvillimin e kompetencave kyçe, edukimin ndërkulturor dhe metodologjinë e edukimit të bashkëmoshatarëve, duke vendosur nxënësit në qendër të procesit të të nxënit si pjesëmarrës aktivë dhe kontribues në transformimin e realitetit të tyre.

Në këtë kuadër, moduli synon zhvillimin e aftësive dhe kompetencave thelbësore për jetën dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve, si:

- analizimi, menaxhimi dhe transformimi konstruktiv i konflikteve në shkollë dhe në komunitet;
- komunikimi paqësor, empatia dhe bashkëpunimi në situata të ndryshme shoqërore;
- pranimi dhe vlerësimi i larmisë kulturore, sfidimi i stereotipeve dhe përfshirja në dialog ndërkulturor;
- ushtrimi i qytetarisë aktive përmes njohjes së të drejtave dhe përgjegjësive dhe angazhimit në nisma sociale dhe advokuese;
- udhëheqja dhe organizimi i veprimtarive në rolin e edukatorit bashkëmoshatar, përmes planifikimit dhe punës në grup;
- analiza kritike e informacionit mediatik dhe digjital, duke identifikuar gjuhën e urrejtjes, manipulimin dhe dezinformimin;
- promovimi i mirëqenies personale, menaxhimi i emocioneve dhe reagimi pozitiv ndaj sfidave.

Qëllimi i modulit “Edukimi i të rinjve për ndërtimin e paqes dhe transformimin e konfliktit” është të aftësojë nxënësit e arsimit të mesëm të lartë që të veprojnë si ndërtues të paqes, agjentë

pozitivë ndryshimi dhe edukatorë bashkëmoshatarësh, duke i pajisur me njohuritë, aftësitë dhe vlerat e nevojshme për të:

- kuptuar shkaqet e konflikteve dhe sfidave që ndikojnë në jetën e tyre;
- zhvilluar forma komunikimi që sfidojnë paragjykimet, diskriminimin dhe ekstremizmin;
- kontribuar në krijimin e një mjedisi shkollor dhe komunitar të sigurt, gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues;
- ndërmarrë nisma konkrete për ndërtimin e paqes dhe promovimin e dialogut ndërkulturor.

2. PËRMBAJTJA E MODULIT

Moduli "Edukimi i të rinjve për ndërtimin e paqes dhe transformimin e konfliktit" është strukturuar në katër tematika kryesore, të cilat integrojnë njohuritë teorike me aftësitë praktike dhe zhvillimin e qëndrimeve të përgjegjshme.

Tematika 1 fokusohet në fuqizimin e të rinjve si ndërtues aktivë të paqes, duke zhvilluar njohuri, qëndrime dhe aftësi për të kuptuar, analizuar dhe transformuar konfliktin përmes dialogut, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit.

Kjo tematikë trajton shkaqet dhe dinamikat e konflikteve, ndikimin e tyre te individët, grupet dhe shoqëria, si dhe mënyrat për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës dhe shndërrimin e konfliktit në mundësi për dialog, gjithëpërfshirje, drejtësi, barazi dhe mirëqenie.

Tematika 2 fokusohet në zhvillimin e kompetencave personale dhe ndërpersonale për shndërrimin e konfliktit, duke theksuar rëndësinë e shembullit personal në përballimin e konflikteve me përgjegjshmëri dhe integritet. Kjo tematikë synon të pajisë nxënësit me vlera dhe aftësi për të adresuar dhunën, për të kapërcyer frikën dhe mosbesimin, si dhe për të promovuar mirëkuptimin, komunikimin efektiv, qëllimin e përbashkët dhe pajtimin.

Tematika 3 fokusohet në dialogun ndërkulturor si një proces edukativ thelbësor për ndërtimin e paqes, mirëkuptimit dhe pajtimit, duke nxitur të rinjtë të kuptojnë dhe të ndërveprojnë në mënyrë konstruktive me individë nga kultura, identitete dhe përvoja të ndryshme. Ajo synon të krijojë hapësira të sigurta mësimi dhe komunikimi, ku nxënësit kanë mundësi të reflektojnë mbi identitetin dhe kulturën, të vënë në pikëpyetje stereotipat dhe paragjykimet, si dhe të

ndajnë qëndrime, përvoja, sfida dhe aspirata, mbi bazën e respektit të ndërsjellë dhe gjithëpërfshirjes.

Tematika 4 fokusohet në fuqizimin e të rinjve si liderë dhe aktorë aktivë të ndryshimit shoqëror, duke u ofruar atyre mundësi dhe mbështetje për të projektuar, advokuar dhe zbatuar veprime konkrete në shërbim të ndërtimit të paqes dhe pajtimit. Duke u mbështetur në kompetencat e fituara në tematikat e mëparshme për analizën dhe transformimin e konfliktit, tematika angazhon nxënësit në organizimin e nismave komunitare dhe zhvillimin e fushatave të advokimit rinor, me qëllim nxitjen e paqes së qëndrueshme dhe pajtimit në komunitetet e tyre.

Moduli lidhet ngushtë me Shkencat shoqërore dhe lëndët që kjo fushë përfshin: qytetari, histori, gjeografi, sociologji, sikurse me lëndët e fushës "Gjuhët dhe komunikimi", duke nxitur të menduarin kritik, bashkëpunimin, përgjegjësinë shoqërore etj.

Njohuritë dhe aftësitë e fituara gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në jetën reale të nxënësve, në marrëdhëniet ndërpersonale, në mjedisin shkollor dhe në komunitet, si dhe lidhen me çështje globale si paqja, demokracia, gjithëpërfshirja, barazia, kohezioni social, zhvillimi i qëndrueshëm etj.

Metodologjia për zhvillimin e modulit

Metodologjia e këtij moduli ndërtohet mbi një qasje aktive dhe ndërvepruese, e cila e vendos nxënësin në qendër të procesit të të nxënit dhe synon të lidhë njohuritë me situata konkrete nga jeta reale, duke nxitur bashkëpunimin, reflektimin dhe angazhimin aktiv të nxënësve. Në këtë kuadër, moduli krijon mundësi edhe për integrim ndërlëndor, duke u lidhur me fusha si qytetaria, gjuha, historia, dhe shkencat shoqërore, në funksion të zhvillimit të kompetencave të përbashkëta.
Kjo qasje mbështetet në disa parime kryesore:

- *Të nxënit përmes përvojës,* ku nxënësit përfshihen në situata reale ose të simuluara (raste studimore, lojëra me role, dilema etj.), për të analizuar dhe reflektuar mbi konfliktin dhe ndërtimin e paqes.
- *Metoda ndërvepruese dhe bashkëpunuese,* si puna në grupe, diskutimet e drejtuara, puna në çifte dhe aktivitetet reflektuese, që nxisin shkëmbimin e ideve, të menduarin kritik etj.

- *Edukimi i bashkëmoshatarëve,* ku nxënësit marrin rol aktiv në ndarjen e njohurive dhe përvojave, duke zhvilluar aftësi udhëheqjeje dhe përgjegjësie sociale.
- *Reflektimi i vazhdueshëm,* që shoqëron çdo veprimtari dhe ndihmon në lidhjen e përvojës me konceptet dhe situatat e jetës reale.
- *Zhvillimi socio-emocional,* përmes ushtrimit të empatisë, dëgjimit aktiv, komunikimit paqësor dhe menaxhimit të emocioneve.
- *Orientimi drejt veprimit,* duke angazhuar nxënësit në hartimin dhe zbatimin e nismave konkrete për ndërtimin e paqes në shkollë dhe komunitet.

Kjo metodologji synon zhvillimin e integruar të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, duke e vendosur nxënësin në rolin e një aktori aktiv në procesin e të nxënit dhe në nxitjen e ndryshimeve pozitive në komunitetin e tij.

3. KLASA/T KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI

Moduli "Edukimi i të rinjve për ndërtimin e paqes dhe transformimin e konfliktit" ofrohet si pjesë e kurrikulës me zgjedhje për nxënësit në arsimin e mesëm të lartë dhe mund të përzgjidhet të zhvillohet në një nga klasat e gjimnazit: në klasën e 10-të, ose në klasën e 11-të, ose në klasën e 12-të, në varësi të interesave, nevojave të nxënësve dhe planifikimit kurrikular të shkollës.
Moduli mund të zhvillohet dhe në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, si një modul ndërdisiplinor që mbështet zhvillimin e kompetencave qytetare, sociale dhe personale të nxënësve.

Shënim!

- *Kur moduli zhvillohet si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, ai i nënshtrohet vlerësimit në të njëjtën mënyrë si lëndët dhe modulet e tjera me zgjedhje, duke përfshirë vlerësimin me notë.*
- *Në rast se moduli zhvillohet në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, vlerësimi nuk kryhet me notë, por realizohet në formën e shlyerjes së modulit, bazuar në pjesëmarrjen aktive dhe përmbushjen e kërkesave të parashikuara.*

4. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN

Moduli sugjerohet të zhvillohet nga mësues të arsimit të mesëm të lartë me formim në fusha që lidhen me edukimin qytetar dhe shoqëror, veçanërisht nga lëndët e fushës "Shkencat shoqërore" (qytetari, histori, gjeografi, sociologji, filozofi dhe psikologji) ose nga fusha "Gjuhët dhe komunikimi". Përparësi u jepet mësuesve me përvojë në trajtimin e temave si

dialogu ndërkulturor, të drejtat e njeriut, ndërtimi i paqes, parandalimi i dhunës, qytetaria aktive.

Moduli mund të zhvillohet gjithashtu nga mësues që kanë ndjekur trajnime profesionale në fusha të tilla si menaxhimi dhe transformimi i konfliktit, edukimi ndërkulturor dhe metodologjitë ndërvepruese, ose që kanë përvojë në punën me të rinjtë dhe në projekte me karakter komunitar.

5. KOHËZGJATJA E MODULIT

Moduli zhvillohet me një orë mësimore në javë.

Nëse zgjidhet në klasën e 10-të ose në klasën e 11-të, moduli zhvillohet me 1 orë mësimore/javë x 36 javë. Nëse zgjidhet në klasën e 12-të, ai zhvillohet me 1 orë mësimore/javë x 34 javë.

Moduli mund të përshtatet në thellësi përmbajtjeje, në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për nivelin e zhvillimit dhe kompetencat e nxënësve të klasës ku zbatohet. Ai mund të zbatohet duke përfshirë veprimtaritë e sugjeruara për secilën tematikë, si dhe veprimtari të tjera që mësuesi i vlerëson të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe kontekstin e nxënësve.

Nr.	Tematika	Orët mësimore të sugjeruara1
1.	Dhuna, konflikti dhe paqja	7
2.	Transformimi i konfliktit	5
3.	Dialogu ndërkulturor	8
4.	Mobilizimi i të rinjve për ndërtimin e paqes	16
TOTALI		**36 ose 34, në varësi të klasës kur zhvillohet moduli[2]**

[1] Orët e sugjeruara për tematika janë orientuese dhe mund të përshtaten nga mësuesit, të cilët kanë fleksibilitetin të riorganizojnë kohën dhe veprimtaritë sipas nevojave të nxënësve dhe kontekstit të klasës.

[2] Nëse moduli zgjidhet në klasën e 10 ose në klasën e 11-të, zhvillohet me 36 orë mësimore vjetore; nëse zgjidhet në klasën e 12-të zhvillohet me 34 orë mësimore vjetore. Mësuesi përshtat përmbajtjen në varësi të numrit të orëve.

6. REZULTATET E TË NXËNIT

Tematika 1: Dhuna, konflikti dhe paqja
Rezultatet e të nxënit *Nxënësi:* ✓ diferencon format e ndryshme të dhunës; ✓ interpreton mënyrat e zakonshme të reagimit ndaj konfliktit dhe shpjegon ndikimin e tyre në rezultatet e konfliktit; ✓ përdor instrumente të analizës së konfliktit për të: o shqyrtuar kontekstin e konfliktit; o identifikuar aktorët, shkaqet themelore, faktorët nxitës, format e shfaqjes dhe pasojat e konfliktit; o identifikuar pikat e mundshme për ndërhyrje dhe zgjidhje; ✓ shpjegon karakteristikat e paqes dhe të ndërtimit të saj; ✓ vlerëson rolin e tij si kontribues në ndërtimin e paqes në mjedisin shkollor dhe komunitar.
Tematika 2: Transformimi i konfliktit
Rezultatet e të nxënit *Nxënësi:* ✓ përshkruan bazat dhe parimet kryesore të transformimit të konfliktit; ✓ argumenton pse transformimi i konfliktit është zgjidhja më e përshtatshme për ndërtimin e paqes së qëndrueshme; ✓ analizon rolin e pushtetit në proceset e shndërrimit të konflikteve dhe ndërtimit të paqes; ✓ demonstron stilet e menaxhimit të konfliktit dhe përfitimet e aftësive të komunikimit jo të dhunshëm; ✓ diferencon midis proceseve të negocimit, ndërmjetësimit dhe dialogut për menaxhimin e situatave konfliktuale.
Tematika 3: Dialogu ndërkulturor
Rezultatet e të nxënit *Nxënësi:* ✓ dallon konceptet e identitetit personal, social dhe kulturor; ✓ argumenton rëndësinë e vlerave dhe aftësive që mundësojnë dialogun ndërkulturor; ✓ shpjegon rëndësinë e dialogut ndërkulturor në krijimin e shoqërive gjithëpërfshirëse, demokratike dhe të drejta;

- ✓ analizon barrierat ndaj dialogut ndërkulturor dhe mënyrat për tejkalimin e tyre;
- ✓ vlerëson përfitimet dhe sfidat e diskutimit të çështjeve kundërshtuese me bashkëmoshatarët;
- ✓ zbaton aftësitë e dialogut ndërkulturor duke treguar tolerancë dhe respekt për diversitetin dhe dallimet kulturore.

Tematika 4: Mobilizimi i të rinjve për ndërtimin e paqes

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ✓ identifikon aktorët e rinj, ekzistues dhe potencialë, të ndërtimit të paqes dhe aktivitetet në komunitet;
- ✓ përshkruan strukturat dhe institucionet që mbështesin ndërtimin e paqes nga të rinjtë;
- ✓ vlerëson aftësitë personale dhe mundësitë për angazhim aktiv në ndërtimin e paqes në nivel vendor dhe kombëtar;
- ✓ zhvillon nisma për ndërtimin e paqes nga të rinjtë;
- ✓ zbaton strategji të aktivizmit rinor, duke përfshirë fushata advokimi që angazhojnë bashkëmoshatarët;
- ✓ përdor dhe zgjedh në mënyrë të përshtatshme forma të ndryshme të medias për të promovuar mesazhet e ndërtimit të paqes;
- ✓ propozon mekanizma që nxisin veprim të ndjeshëm ndaj diversitetit në nivel vendor.

7. VEPRIMTARITË PRAKTIKE

Në vazhdim janë përshkruar veprimtari praktike të sugjeruara, të grupuara sipas tematikave të modulit. Mësuesi është i lirë të përzgjedhë midis veprimtarive të sugjeruara në modul, mund t'i përshtatë ato si dhe mund të plotësojë me veprimtari të tjera të cilat e mbështesin për të trajtuar tematikat dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënit.

Tematika 1: Dhuna, konflikti dhe paqja

Veprimtari: Çfarë lloj dhune është kjo?

Përshkrimi i veprimtarisë:

- *Stuhi mendimesh:* Mësuesi zhvillon me nxënësit diskutimin rreth dhunës si koncept dhe formave në të cilat mund të shfaqet ajo dhe shënon përgjigjet në tabelë.

Për të orientuar dhe nxitur diskutimin shënon në tabelë një përkufizim për dhunën: "Dhuna nënkupton veprime, fjalë, qëndrime, struktura ose sisteme që shkaktojnë dëm/lëndim fizik, psikologjik, social dhe/ose që i pengojnë njerëzit të arrijnë potencialin e tyre të plotë."

- *Punë në grupe:* Nxënësit organizohen në grupe të vogla. Mësuesi i shpërndan secilit grup një kopje të fletës së punës me situatat e rastit që prezantojnë shembuj të sjelljeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të dhunshme. Në varësi të kohës në dispozicion, nxënësit mund të shqyrtojnë një ose disa situata rasti.

Fletë pune: Raste studimore

Rast studimor: Bashkëshorti konsumon alkool çdo ditë pas pune për të larguar stresin dhe problemet e përditshme. Kur gruaja dhe fëmijët i drejtohen për çështje të ndryshme, ai shpesh acarohet, ngre zërin dhe në disa raste ushtron edhe dhunë fizike ndaj tyre. Më pas, ai kërkon gjithmonë falje dhe premton se kjo nuk do të përsëritet, duke ia atribuar sjelljen e tij "provokimeve" nga ana e familjarëve. Gruaja e tij ndihet gjithnjë e më shumë në ankth dhe depresion. Ajo nuk guxon të shprehet më dhe përjeton pasiguri sa herë që ai kthehet në shtëpi i stresuar ose pasi ka konsumuar alkool me shokët. Fëmijët po hyjnë gjithmonë e më shumë në telashe për shkak të mos frekuentimit të shkollës dhe po përfshihen në aktivitete të rrezikshme jashtë shkollës me më të rritur.

Rast studimor: Gjatë një ndeshjeje futbolli ndërmjet shkollës, djemtë nga lagje të ndryshme fillojnë të grinden. Disa nga djemtë bërtasin dhe përdorin komente provokuese e fyese ndaj të tjerëve për shkak të etnisë dhe fesë së tyre. Asgjë e veçantë... të rriturit thonë të njëjtën gjë. Në qytetet e tyre, qëndrojnë ende simbole dhe slogane fashiste të mbishkruara nga të rinjtë vendas. As pronarët e ndërtesave, dhe as autoritetet e qyteteve nuk i kanë fshirë mbishkrimet. Incidenti në futboll është një prej tyre. Më pas, djemtë e diskutojnë ngjarjen me shokët dhe shoqet e tyre. Dikush thotë: "Injorojini, ata janë idiotë; djemtë e tjerë janë në rregull, unë i njoh". Megjithatë, shumë të tjerë mendojnë se është më mirë që secili të qëndrojë me grupin e vet dhe të shmangë afrimin me të tjerët.

Rast studimor: Një vajzë që është mbipeshë dhe ka vështirësi në shkollë, merr çdo ditë mesazhe fyese nga bashkëmoshatarët e saj në telefon dhe në profilin e saj në rrjetet sociale, ku i thuhet se është "e shëmtuar" dhe "budallaqe". Ajo vë re teksa ata shohin reagimet e saj për mesazhet, duke qeshur me të kur ajo acarohet. Mesazhet e fundit shkojnë edhe më tej,

duke i thënë se askush nuk do ta konsiderojë tërheqëse dhe se askush nuk do ta dojë. Vajza ndihet e lodhur emocionalisht dhe nuk arrin më ta përballojë këtë situatë. Me kalimin e kohës, një pjesë e saj fillon t'i besojë këtyre fjalëve.

Pyetjet në vazhdim ndihmojnë për të orientuar diskutimin për secilin rast gjatë punës në grupe:

- ✓ Çfarë lloj dhune paraqitet në këtë rast?
- ✓ Cilat qëndrime, sjellje dhe mosveprime ndihmojnë në këtë situatë të dhunshme?
- ✓ Cili mendoni se do të jetë rezultati/efekti i kësaj situate?
- ✓ A jeni ndeshur me këtë lloj dhune në komunitetin tuaj?
- ✓ A keni qenë dëshmitar në një situatë të ngjashme? Çfarë ka ndodhur?
- ✓ Kujt mund t'i drejtohemi dhe çfarë mund të bëhet për të parandaluar ose reaguar ndaj kësaj lloj dhune? (p.sh. familja, shokët, fqinjët, një mësues apo mjek i besuar, komuniteti vendas, autoritetet publike, media etj.)

- *Diskutim dhe reflektim:* Në përfundim, mësuesi zhvillon me nxënësit diskutimin rreth konceptit të dhunës, llojeve të saj dhe mënyrës si ndërveprojnë dhe ndikojnë te njëra-tjetra format fizike, kulturore dhe strukturore të dhunës.

Veprimtari: Përkufizimi i konfliktit
Përshkrimi i veprimtarisë:

*Punë në çifte***:** Nxënësit ndahen në çifte dhe pajisen me letra A4 dhe lapustila. Çdo çift diskuton dhe realizon një skicë që përfaqëson mënyrën se si e kupton konfliktin, pa përdorur fjalë ose shpjegime të shkruara. Qëllimi është shprehja vizuale e ideve, ndjenjave dhe përfytyrimeve personale mbi konfliktin. Secili çift prezanton skicën e tij para grupit të madh, duke shpjeguar kuptimin që i ka dhënë konfliktit. Prezantimet shoqërohen me diskutime të shkurtra, të lehtësuara nga mësuesi.
Harta e koncepteve: Mësuesi vizaton një rreth të madh në tabelë dhe shkruan fjalën "konflikt" në qendër. Nxënësit ftohen të shprehin spontanisht fjalë ose fraza që i lidhin me konfliktin (p.sh., situata tipike, palë të përfshira, ndjenja, lloje konfliktesh, burime dhe pasoja). Të gjitha përgjigjet pranohen pa gjykim dhe shënohen rreth konceptit qendror, duke ndërtuar një hartë konceptesh. Procesi i mbledhjes së ideve vazhdon derisa nxënësit të mos kenë më sugjerime. Nëse vërehet se shumica e termave lidhen me përvoja negative ose me dhunën, mësuesi e thekson këtë pirje dhe nxit reflektimin e grupit mbi arsyet e këtij perceptimi.

Diskutim i strukturuar: Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i drejtuar përmes pyetjeve të tilla, si:

- ✓ Pse reagimet tona ndaj konfliktit janë shpesh negative?
- ✓ A mund të ketë konflikti funksione pozitive?

Diskutimi ndihmon nxënësit të kuptojnë konfliktin si pjesë normale të jetës shoqërore dhe si mundësi për ndryshim, duke theksuar adresimin e tij në mënyrë paqësore dhe jo të dhunshme.
Punë në grup: Nxënësit ftohen të propozojnë dhe të bien dakord për një përkufizim të përbashkët të konfliktit dhe të funksioneve të tij, bazuar në diskutimet e zhvilluara. Veprimtaria përmbyllet me prezantimin e përkufizimit referues nga materiali i modulit dhe lidhjen e tij me reflektimet dhe përfundimet e nxënësve.
Reflektim: Si zgjerim i veprimtarisë, nxënësit njihen me nivelet e ndryshme të konfliktit: personal, ndërpersonal, brenda grupit, ndërmjet grupeve dhe ndërkombëtar. Diskutimi shoqërohet me reflektim mbi përvojat personale në aktivitete rinore ose komunitare, nivelet e konfliktit të adresuara, si dhe përfitimet dhe sfidat e hasura.

Veprimtari: Nivelet dhe faktorët nxitës të konfliktit
Përshkrimi i veprimtarisë

Prezantim i drejtuar: Mësuesi prezanton konceptin e konfliktit dhe nivelet kryesore të tij (personal, ndërpersonal, brenda grupit, ndërmjet grupeve), duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe shembuj ilustrues. Ai/ajo ndalet te secili nivel për të sqaruar karakteristikat kryesore dhe për të ndihmuar nxënësit të dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre.
Nxënësit dëgjojnë, bëjnë pyetje sqaruese dhe marrin pjesë aktive në diskutim, duke reflektuar mbi përvojat e tyre personale, shkollore ose komunitare dhe duke i lidhur ato me konceptet e prezantuara.
Diskutim: Mësuesi nxit diskutimin përmes pyetjeve të hapura, si p.sh.:

- ✓ Në cilat situata të jetës së përditshme hasim konflikte?
- ✓ A janë të gjitha konfliktet të njëjta?
- ✓ Çfarë i bën ato të ndryshme?

Nxënësit ndajnë shembuj konkretë, dëgjojnë këndvështrimet e njëri-tjetrit dhe përpiqen të kuptojnë mënyra të ndryshme se si shfaqet konflikti në kontekste të ndryshme. Mësuesi siguron një klimë të sigurt dhe respektuese, ku çdo mendim pranohet pa gjykim.

Prezantim i drejtuar: Mësuesi prezanton faktorët kryesorë që nxisin konfliktin (vlerat, pushteti, të drejtat, identiteti, nevojat, ideologjia etj.), duke shpjeguar secilin faktor dhe duke dhënë shembuj ilustrues. Ai/ajo orienton nxënësit të kuptojnë ndërthurjen e këtyre faktorëve në situata reale. Nxënësit dëgjojnë, marrin shënime, sjellin shembuj nga përvoja e tyre dhe marrin pjesë në diskutim, duke reflektuar mbi mënyrën se si faktorë të ndryshëm ndikojnë në lindjen e konflikteve.

Punë në grupe të vogla: Mësuesi ndan nxënësit në grupe të vogla, shpërndan fletët e punës me skenarët e konfliktit dhe jep udhëzime të qarta për detyrën. Gjatë punës në grupe, mësuesi mbështet diskutimet, bën pyetje nxitëse dhe ndihmon grupet të thellojnë analizën. Nxënësit bashkëpunojnë brenda grupit, lexojnë dhe diskutojnë skenarët, identifikojnë nivelet e konfliktit dhe faktorët nxitës, si dhe argumentojnë zgjedhjet e tyre. Mësuesi fton secilin grup të paraqesë rezultatet e punës dhe lehtëson diskutimin e përbashkët, duke krahasuar këndvështrimet e ndryshme dhe duke sqaruar keqkuptimet.

FLETË PUNE **Tabela "Nivelet e konfliktit[1] dhe faktorët nxitës[2]"**			
Skenari	**Niveli i konfliktit**	**Faktori kryesor nxitës**	**Faktorë të tjerë**
Dy persona konkurrojnë për të njëjtin pozicion pune në një organizatë.			
Një baba e ka të vështirë të marrë vendimin që të lerë familjen e tij për të punuar jashtë vendit.			
Tensionet ndërmjet BE-së dhe një qeverie rriten për shkak të mungesës së mbrojtjes së të drejtave të pakicave.			
Një nënë kundërshton marrëdhënien e vajzës së saj me një të ri të një etnie			

tjetër dhe, si formë ndëshkimi, i ndalon vazhdimin e kësaj lidhjeje.			
Një krizë globale shkakton tension për mirëqenien personale dhe financiare.			
Një konflikt zhvillohet ndërmjet komuniteteve lidhur me mënyrën se si do të përkujtohen viktimat e luftës.			
Një konflikt zhvillohet ndërmjet komuniteteve lidhur me mënyrën se si do të nderohen heronjtë e luftës.			
Lind një konflikt ndërmjet qeverisë dhe një grupi etnik.			

Për të plotësuar tabelën nxënësi, në varësi të skenarit, përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme të konfliktit, identifikon kryesor nxitës si dhe faktorë të tjerë.

1. Nivelet kryesore të konfliktit: personal, ndërpersonal, brenda grupit, ndërmjet grupeve
2. Faktorët nxisin konfliktin përfshijnë: vlerat, pushteti, të drejtat, identiteti, nevojat, ideologjia etj.

Shembull plotësimi:

Skenari	**Niveli i konfliktit**	**Faktori kryesor nxitës**	**Faktorë të tjerë**
Dy persona konkurrojnë për të njëjtin pozicion pune në një organizatë.	Ndërpersonal	Pushteti	Nevojat, vlerat
Qytetarët protestojnë në mënyrë të dhunshme kundër korrupsionit.	Personal	Nevojat	Vlerat, identiteti

Mësuesi prezanton kuadrin e nevojave njerëzore dhe të drejtave të njeriut dhe udhëzon nxënësit të reflektojnë mbi lidhjen e tyre me konfliktin dhe dhunën. Nxënësit reflektojnë mbi shembuj konkretë, lidhin konfliktet me nevoja ose të drejta të paplotësuara dhe diskutojnë mundësi për zgjidhje paqësore.

Veprimtari: Dilema e karrigeve

Përshkrimi i veprimtarisë:

Punë në grupe: Nxënësit vendosen në një sallë pa tavolina, me nga një karrige për secilin. Karriget vendosen fillimisht në formë rrethi, për të krijuar një ndjenjë barazie dhe ndërveprimi. Mësuesi shpjegon rregullat bazë të sigurisë dhe thekson se nuk lejohet përdorimi i forcës ose veprimeve që mund të lëndojnë të tjerët.

Nxënësit ndahen në tre grupe (A, B dhe C). Secilit grup i jepet një udhëzim i shkruar, i cili duhet të mbahet i fshehtë dhe të mos u bëhet i ditur grupeve të tjera. Udhëzimet janë të ndryshme dhe ndoshta kontradiktore:

- ✓ vendosja e të gjitha karrigeve në formë rrethi;
- ✓ vendosja e të gjitha karrigeve pranë derës;
- ✓ vendosja e të gjitha karrigeve pranë dritares.

Çdo grup ka 10 minuta kohë për të përmbushur udhëzimin e vet. Nxënësit ftohen të fillojnë ushtrimin njëkohësisht, pa u dhënë udhëzime shtesë për mënyrën e zgjidhjes së situatës. Gjatë procesit, mësuesi vëzhgon dinamikat e grupit dhe, nëse është e nevojshme, ndërhyn për të shmangur përshkallëzimin e agresionit.

Diskutim: Pas një kohe të shkurtër, ushtrimi ndërpritet. Nxënësit ftohen të reflektojnë mbi përvojën e tyre përmes një diskutimi të strukturuar. Pyetjet udhëzuese ndihmojnë nxënësit të analizojnë emocionet, sjelljet dhe zgjedhjet e tyre, si dhe mënyrën se si u përballën me mendimet dhe interesat e ndryshme të të tjerëve. Diskutimi fokusohet në mënyrën se si pjesëmarrësit reaguan ndaj konfliktit: nëse bashkëpunuan, debatuan, u përpoqën të bindnin të tjerët, u tërhoqën apo përdorën forma presioni. Analizohet gjithashtu tensioni ndërmjet ndjekjes së udhëzimeve dhe ruajtjes së marrëdhënieve me të tjerët.

Mësuesi përmbyll ushtrimin duke theksuar se udhëzimet e dhëna nuk mund të përmbushen me sukses pa komunikim, konsultim dhe bashkëpunim. Ushtrimi shërben për të nxjerrë në pah rëndësinë e zgjidhjes jo agresive të konfliktit dhe nevojën për qasje krijuese dhe elastike.

Reflektim individual: Nxënësit ftohen të mendojnë se si do ta menaxhonin situatën nëse do t'u jepej një mundësi e dytë dhe ta lidhin përvojën me situata reale nga jeta e përditshme, komuniteti apo shoqëria. Diskutimi shtrihet edhe në rolin e këtyre aftësive në ndërtimin e paqes.

Seanca përmbyllet duke theksuar se ekzistojnë zgjidhje të shumta të mundshme për një situatë konflikti dhe se krijimtaria, dialogu dhe kompromisi janë thelbësore për arritjen e tyre. Shembujt e zgjidhjeve alternative paraqiten për të përforcuar mesazhin se konfliktet mund të transformohen në mundësi për bashkëpunim dhe mirëkuptim.

Veprimtari: Paqja dhe ndërtimi i paqes

Përshkrimi i veprimtarisë:

Diskutim: Në grup të madh, mësuesi shtron pyetjen: *"Çfarë do të thotë fjala 'paqe' për ju?"*. Nxënësit ndajnë mendimet e tyre lirshëm, ndërsa përgjigjet shkruhen në tabelë.

Punë në grupe: Nxënësit ndahen në grupe të vogla për të punuar në mënyrë bashkëpunuese. Secilit grup i kërkohet të zgjedhë një nga dy format:

- ✓ të realizojë një vizatim/pikturë që shpreh ide paqen, ose
- ✓ të përgatisë një lojë me role 3-4 minutëshe që pasqyron paqen.

Tema mund të jetë:

- ✓ paqja në familje,
- ✓ paqja në komunitet,
- ✓ paqja në kontekstin kombëtar.

Grupet kanë 15 minuta kohë për përgatitje. Grupet rikthehen në grupin e madh dhe secili prezanton punën e vet. Çdo grup ka 3–5 minuta për të ndarë "paqen e tyre" dhe për të shpjeguar mesazhin që përcjell.

Lojë me role: Vizatimet vendosen në mur, ndërsa lojërat me role titullohen dhe afishohen për t'u parë nga të gjithë pjesëmarrësit. Mësuesi udhëheq diskutimin përmes pyetjeve:

- ✓ Çfarë është "paqja" duke u bazuar në të gjitha prezantimet?
- ✓ Si duket një familje, komunitet ose shoqëri paqësore?
- ✓ A mjafton vetëm mungesa e luftës dhe dhunës?
- ✓ Çfarë tjetër nevojitet që njerëzit dhe shoqëria të ndihen në paqe?

Prezantim i drejtuar: Prezantohen shkurt konceptet: paqja, paqja e brendshme, ndërtimi i paqes, ruajtje e paqes, vendosje e paqes.

Për secilin koncept nxirren shembuj nga puna e grupeve dhe jepet një përkufizim i thjeshtë. Diskutohet se në cilët nivele ndërtohet paqja (individual, familjar, komunitar, shoqëror) dhe cilët janë aktorët kryesorë (individë, të rinj, institucione, organizata).

Punë në grupe: Në grupe të vegjël, nxënësit mendojnë ide konkrete për aktivitete ndërtimi të paqes ku të rinjtë mund të angazhohen në nivele të ndryshme. Kur diskutimi vazhdon me të gjithë klasën, secili grup ndan idetë e veta. Ato shkruhen në tabelë dhe diskutohen shkurtimisht.

Nxënësit reflektojnë se cila qasje është më e përshtatshme për realitetin e tyre të tanishëm. Idetë afishohen në mur dhe mund të përdoren më vonë për planifikim veprimesh konkrete.

Veprimtari: Pema e konfliktit/pema e zgjidhjes
Përshkrimi i veprimtarisë:

Prezantim i drejtuar dhe diskutim i shkurtër: Mësuesi prezanton në mënyrë të strukturuar analizën e konfliktit, elementet kryesorë dhe rëndësinë e saj për ndërhyrje dhe zgjidhje të qëndrueshme. Gjatë prezantimit nxënësit mund të bëjnë pyetje dhe të japin mendime të shkurtra.
Diskutim i drejtuar: Mësuesi udhëheq një diskutim të shkurtër duke theksuar se:

- ✓ analiza e konfliktit ndihmon në kuptimin e shkaqeve, dinamikave dhe pasojave;
- ✓ është bazë për zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme;
- ✓ të rinjtë mund të luajnë rol aktiv në këtë proces.

Shpjegim dhe ilustrim: Nxënësit njihen shkurt me disa instrumente kryesore:

- ✓ pema e konfliktit;
- ✓ harta e marrëdhënieve (aktorët);
- ✓ pikat bashkuese dhe ndarëse.

Fokusi vendoset te pema e konfliktit si mjet kryesor i veprimtarisë.
Demonstrim vizual: Mësuesi vizaton një pemë në tabelë/flipchart dhe shpjegon elementet:

- ✓ rrënjët – përfaqësojnë shkaqet e konfliktit;
- ✓ trungu – përfaqëson problemin kryesor;
- ✓ degët/gjethet – përfaqësojnë pasojat e konfliktit.

Punë në grupe: Nxënësit ndahen në grupe dhe:

- ✓ zgjedhin një konflikt;
- ✓ analizojnë konfliktin duke plotësuar pemën (shkaqet, problemi, pasojat).

Mësuesi monitoron dhe mbështet punën e grupeve.
Prezantim dhe diskutim: Çdo grup prezanton pemën e konfliktit. Diskutohet mbi:

- ✓ mënyrën e analizës;
- ✓ dallimet midis grupeve;
- ✓ thellësinë e identifikimit të shkaqeve dhe pasojave.

Reflektim i drejtuar: Nxënësit diskutojnë se si analiza e konfliktit mund të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve. Mësuesi i orienton drejt idesë që pema e konfliktit shërben si bazë për ndërtimin e pemës së zgjidhjes.

Tematika 2: Transformimi i konfliktit

Veprimtari: Mënyrat personale të trajtimit të konflikteve
Përshkrimi i veprimtarisë:

Punë individuale dhe vetë reflektim: Mësuesi shpërndan "Formularin e vlerësimit të mënyrave personale të trajtimit të konflikteve" dhe u kërkon nxënësve ta plotësojnë individualisht. Nxënësit reflektojnë mbi mënyrën e tyre të trajtimit të konflikteve dhe bëjnë pikëzimin e rezultateve.
Diskutim në grup: Pas përfundimit të pyetësorit, mësuesi udhëheq një diskutim të hapur mbi përvojën e nxënësve. Nxënësit ndajnë (vullnetarisht) çfarë kanë zbuluar për veten dhe si ndihen në lidhje me rezultatet.
Shpjegim dhe udhëzim: Mësuesi shpjegon se nxënësit do të punojnë me metodën "mozaik", ku secili grup do të bëhet "ekspert" i një mënyre të trajtimit të konfliktit dhe më pas do t'ua prezantojë të tjerëve.
Punë në grupe: Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secilit grup i caktohet një mënyrë e trajtimit të konfliktit.

- ✓ Lexojnë individualisht përshkrimin që u caktohet.
- ✓ Diskutojnë në grup për ta kuptuar atë, duke u udhëhequr nga pyetje si:

  - Si funksionon kjo mënyrë?
  - Cilat janë përparësitë dhe kufizimet?
  - Në cilat situata përdoret më mirë?

Riorganizim i grupeve dhe shkëmbim njohurish: Nxënësit riorganizohen në grupe të reja, ku çdo grup përmban nga një "ekspert" për secilën mënyrë të trajtimit të konfliktit. Secili prezanton qasjen e tij dhe ndan informacionin me të tjerët.
Diskutim i drejtuar në grupe: Grupet diskutojnë rreth pyetjeve reflektuese, si:

- ✓ Me cilën mënyrë të trajtimit të konfliktit ndiheni më rehat dhe pse?
- ✓ Sa e rëndësishme është zgjidhja e konflikteve në marrëdhëniet tuaja?
- ✓ Si mund të përmirësoni mënyrën e trajtimit të konflikteve?

Reflektim dhe diskutim përmbyllës: Grupet ndajnë disa nga përfundimet e tyre. Mësuesi jep komente pozitive dhe drejton reflektimin përfundimtar me pyetje, si:

- ✓ Si do ta përshtatni qasjen tuaj në situata të ndryshme konflikti?
- ✓ Pse është i rëndësishëm elasticiteti në trajtimin e konflikteve?
- ✓ Cila mënyrë është më e përshtatshme për zgjidhje paqësore dhe pse?

Përmbledhje nga mësuesi: Mësuesi thekson se individët përdorin mënyra të ndryshme në varësi të situatës dhe se ndërgjegjësimi mbi to ndihmon në përmirësimin e marrëdhënieve dhe zgjidhjen më efektive të konflikteve.

FLETË PUNE

FORMULARI I VLERËSIMIT TË MËNYRAVE PERSONALE TË TRAJTIMIT TË KONFLIKTEVE

QARKONI PËRGJIGJEN që ju përshkruan më së miri. Tregohuni të sinqertë, pasi ky anketim ju ndihmon të mësoni rreth mënyrave që përdorni për të trajtuar konfliktet. Asnjë përgjigje nuk quhet e gabuar.

Nr.	Pohimi	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithmonë
	Unë i diskutoj problematikat me të tjerët për të gjetur zgjidhje që plotësojnë nevojat e të gjithëve.	1	2	3	4
	Unë përpiqem të negocioj dhe të ndjek qasjen "marr dhe jap" në situata problematike.	1	2	3	4
	Unë përpiqem të përmbush pritshmëritë e të gjithëve.	1	2	3	4
	Unë mund të debatoj për idenë time dhe këmbëngul për përparësitë e pikëpamjes sime.	1	2	3	4

	Nëse ka mosmarrëveshje, unë mbledh sa më shumë informacione të mundem dhe i mbaj të hapura linjat e komunikimit.	1	2	3	4
	Nëse e gjej veten pjesë të një debati, zakonisht flas pak dhe përpiqem të largohem sa më shpejt.	1	2	3	4
	Unë përpiqem që t'i shoh konfliktet nga të dyja anët. Çfarë më nevojitet? Çfarë i nevojitet tjetrit? Cilat janë problematikat e përfshira?	1	2	3	4
	Unë parapëlqej të bie në një kompromis kur zgjidh problemet.	1	2	3	4
	Konfliktet i konsideroj ngazëlluese; më emocionon beteja e fjalëve që vijon më pas.	1	2	3	4
	Ndjehem në ankth dhe i/e frikësuar kur nuk bie dakord me dikë.	1	2	3	4
	Unë përpiqem të plotësoj dëshirat e miqve dhe familjes sime.	1	2	3	4
	Unë mund ta kuptoj se çfarë duhet të bëj dhe zakonisht kam të drejtë.	1	2	3	4
	Unë pranoj të bie në një kompromis për të zgjidhur ngërçin.	1	2	3	4
	Nuk e kam problem që mos të marr atë që dua, nëse e ruaj paqen.	1	2	3	4
	I shmang ndjenjat e forta duke mos i ndarë mendimet e mia kundërshtuese me të tjerët.	1	2	3	4

Pikëzimi i Vlerësimit të Mënyrave Personale të Trajtimit të Konflikteve

Sikundër e parashtruam, 15 pohimet përkojnë me pesë mënyrat e trajtimit të konflikteve. Për të gjetur mënyrën tuaj të trajtimit të konfliktit, mblidhni pikët për çdo pohim përkatës për mënyrat. Mënyra me pikët më të larta tregon strategjinë tuaj të parapëlqyer. Mënyra me pikët më të ulëta tregon strategjinë tuaj më pak të parapëlqyer. Megjithatë, të gjitha mënyrat kanë të mirat dhe të metat e tyre, ndaj është e rëndësishme që të dini se kur dhe si të përdorni mënyrën e duhur për çdo situatë konflikti.

Pohimet përkatëse për mënyrat e trajtimit të konfliktit	**Pyetje**	**Gjithsej**
Konkurrenca	4, 9, 12	
Shmangia	6, 10, 15	
Bashkëpunimi	1, 5, 7	
Akomodimi	3, 11, 14	
Kompromisi	2, 8, 13	

Rezultatet:

- ✓ Mënyra ime e parapëlqyer për të trajtuar konfliktet është: .....
- ✓ Mënyra e trajtimit të konflikteve mbi të cilën duhet të punoj është: .....
- ✓ Kur mundem ta përdor këtë mënyrë apo një tjetër për trajtimin e konflikteve?

Veprimtari: Komunikimi jo i dhunshëm

Përshkrimi i veprimtarisë:

Nxitja e diskutimit fillestar: Mësuesi organizon nxënësit në formë rrethi dhe nxit një diskutim të hapur duke i ftuar nxënësit të ndajnë përvoja personale të situatave konfliktuale dhe mënyrën si kanë reaguar në ato raste. Mësuesi dëgjon aktivisht, orienton diskutimin dhe krijon një klimë të sigurt për shprehje.

Prezantimi i konceptit: Mësuesi prezanton shkurtimisht konceptin e komunikimit jo të dhunshëm dhe shpjegon katër hapat kryesorë të tij (Vëzhgoni pa vlerësuar; Shprehini ndjenjat; Lidhini ndjenjat me nevojat; Bëni kërkesa, mos jepni urdhra), duke përdorur shembuj konkretë ose duke i paraqitur në flipchart/fletë pune.

Komunikimi jo i dhunshëm[3] (KJDH) është një instrument komunikimi që njerëzit mund ta mësojnë për të zgjidhur konflikte dhe për të identifikuar zgjidhje në mënyrë paqësore. Ky lloj komunikimi lehtëson rrjedhën e komunikimit, që nevojitet për të shkëmbyer informacione dhe për të zgjidhur dallime. Megjithatë, së pari, është e rëndësishme të njohim se shpeshherë në jetën e përditshme, njerëzit mund të përdorin një gjuhë agresive, gjykuese ose fajësuese, pa e kuptuar. Sa shpesh shohim njerëz që ua hedhin fajin dhe përgjegjësinë të tjerëve, duke i bërë të ndjehen fajtorë dhe të hidhen në mbrojtje, duke i bërë të mbyllen në vetvete në vend që të komunikojnë në një mënyrë që mundëson shkëmbimin e hapur të ndjenjave dhe nevojave, dhe që zhvillon lidhje dhe bashkëpunim? Komunikimi jo i dhunshëm na ndihmon të reflektojmë rreth gjuhës që përdorim për të komunikojmë më mirë duke u lidhur me anën njerëzore të dikujt, teksa përqendrohemi në vlerat dhe nevojat e çdokujt. Nxit përdorimin e gjuhës që rrit vullnetin e mirë dhe ndihmon në shmangien e gjuhës, që shkakton mëri dhe vetëvlerësim të ulët. Bazohet në idenë që të gjitha qeniet njerëzore kanë kapacitet për dhembshuri dhe zgjedhin dhunën apo sjelljet e dëmshme vetëm kur nuk i njohin më strategjitë e efektshme për përballimin e nevojave të tyre. Qasja e KJDH-së na ndihmon të shmangim përshkallëzimin e një situate konflikti në dhunë. Komunikimi jo i dhunshëm kërkon dy aftësi kyçe:

Mesazhet që fillojnë me "unë": flisni duke u mbështetur në pikëpamjen, mendimet, ndjenjat dhe nevojat tuaja. Nuk duhet të shtireni se e dini se çfarë po ndodh brenda personit përballë jush ose përse veproi në një mënyrë të caktuar. Ne nuk e dimë.

Të dëgjuarit aktiv dhe empatik: qëndroni në heshtje dhe dëgjoni me kujdes e me vëmendje personin tjetër, duke u lidhur me nevojat e tij dhe duke mos marrë asgjë personale.

Katër hapat për komunikim jo të dhunshëm

Vëzhgoni pa vlerësuar – Filloni duke përshkruar veprimin ose situatën që po shkakton problemin. Ky duhet të jetë pohim asnjanës: ju thjesht shprehni atë që shikoni ose dëgjoni objektivisht, bazuar në pikëpamjen tuaj pa u ndikuar nga asnjë gjykim, vlerësim, etiketim ose akuzë. Shembull: "Dje muzika ishte e lartë".

Shprehini ndjenjat – Në këtë hap ju shprehni ndjenjat tuaja. Ju jeni përgjegjës për atë që ndjeni dhe nuk i fajësoni të tjerët. Ndani me të tjerët se si ndjeheni në një situatë të caktuar,

[3] UNOY (2018), Paketa e Trajnimit "Të Rinjtë për Paqen", f. 42

duke përfshirë ndjenjat dhe ndjesitë tuaja. Shembull: "Ndjehem i irrituar dhe i stresuar kur muzika është e lartë, pasi nuk fle dot gjumë".

Lidhini ndjenjat me nevojat – Tani përshkruani nevojën e fshehur pas ndjenjave që sapo shprehët. Pra, na tregoni se çfarë ju nevojitet për t'u ndjerë të sigurt dhe të përmbushur. Nevojat dallojnë nga strategjitë, faji ose të menduarit me "duhet". Përpiquni të tregoheni sa më të sinqertë dhe të hapur në shprehjen e ndjenjave tuaja. Shembull: "Duhet të fle të paktën tetë orë për të punuar siç duhet. Kam frikë se mund të humbas punën dhe mund të mos përmbush përgjegjësitë e mia familjare".

Bëni kërkesa, mos jepni urdhra – hapi i fundit është që të shprehni rezultatin tuaj të parapëlqyer dhe të bëni një kërkesë. Kjo do të thotë që duhet të vendosni se çfarë dëshironi që të ndodhë dhe çfarë kërkoni që të bëjë partneri juaj në konflikt. Kërkesat janë konkrete, specifike, të arritshme dhe bindëse. Shembull: "A dëshironi që të fikim muzikën nga ora 10 e darkës apo dëshironi të dëgjoni në kufje?"

Lojë me role: Mësuesi përzgjedh disa nga situatat e prezantuara nga nxënësit dhe fton vullnetarë që t'i interpretojnë ato përmes lojës me role. Nxënësit udhëzohen të rishikojnë mënyrën e trajtimit të konfliktit duke zbatuar katër hapat e komunikimit jo të dhunshëm.

*Reflektimi dhe diskutimi***:** Pas çdo interpretimi, mësuesi nxit diskutim në grup për të analizuar alternativat e përdorura, për të identifikuar ndjenjat dhe nevojat e palëve, si dhe për të reflektuar mbi mënyra më efektive komunikimi.

Përmbledhja dhe nxjerrja e përfundimeve: Mësuesi udhëheq një përmbledhje të veprimtarisë duke theksuar rëndësinë e identifikimit të nevojave të përbashkëta, sfidat në përdorimin e kësaj qasjeje dhe kufizimet e saj në situata të caktuara (p.sh. raste të dhunës së drejtpërdrejtë).

Veprimtari: Aftësitë e ndërmjetësimit

Përshkrimi i veprimtarisë:

Prezantimi i konceptit: Mësuesi trajton shkurtimisht konceptin e shndërrimit të konfliktit dhe prezanton ndërmjetësimin, duke shpjeguar synimet, parimet dhe dallimet e tij nga qasje të tjera (negocimi, dialogu për paqen). Shpërndan udhëzimet dhe shpjegon procesin e ndërmjetësimit.

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është një proces përmes së cilit një palë e tretë i ndihmon palët që të zgjidhin konfliktin e tyre. Ndërmjetësimi është një proces nëpërmjet të cilit palët e përfshira në një

mosmarrëveshje mund të gjejnë mënyra për ta zgjidhur në mënyrë konstruktive, me ndihmën e një ndërmjetësuesi të trajnuar. Procesi i ndërmjetësimit NUK është seancë gjyqësore, proces për të shpallur fajësinë dhe pafajësinë, ose një proces për të gjetur kush ka dhe kush nuk ka të drejtë. Procesi i ndërmjetësimit NUK merr vendime për palët, por lehtëson procesin e gjetjes së zgjidhjeve nga vetë palët. Ndërmjetësuesi përvetëson aftësi për të ndihmuar palët në konflikt që të zgjidhin mosmarrëveshjet, dëgjon me vëmendje pikëpamjet e të dyja palëve, si dhe bën pyetje rreth mosmarrëveshjes për të sqaruar problematikat. Ndërmjetësuesi i ndihmon palët që të kuptojnë dhe të shprehin interesat e tyre dhe ta shohin mosmarrëveshjen nga një pikëpamje e qartë dhe e përmbledhur, në mënyrë që të fillojnë të diskutojnë dhe të vlerësojnë mundësitë për ta zgjidhur. Procesi i ndërmjetësimit varet nga ndërmjetësuesi dhe kultura ku zhvillohet. Ai përbëhet nga katër faza:

- ***Hyrja**:* Gjatë hyrjes, ndërmjetësuesi përshëndet palët dhe përshkruan procesin dhe rolin e ndërmjetësuesit. Palët, së bashku me ndërmjetësuesin, vendosin rregullat bazë për seancën e ndërmjetësimit.
- ***Rrëfimi i historisë:*** Gjatë kësaj faze, çdo palë tregon historinë e vet sipas pikëpamjes së vet. Zakonisht, ndërmjetësuesi përmbledh secilën prej historive, pasi të jenë rrëfyer nga secila palë. Ndërmjetësuesi rendit problematikat për zgjidhje dhe palët bien dakord.
- ***Zgjidhja e problemeve.*** Gjatë kësaj faze, palët angazhohen për të gjetur zgjidhje dhe për të vlerësuar mundësi të ndryshme për ta zgjidhur konfliktin.
- ***Marrëveshja:*** Pas vlerësimit të mundësive të ndryshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen, palët vendosin mbi zgjidhjen. Ndërmjetësuesi lehtëson diskutimin rreth hollësive të marrëveshjes.

Punë në grupe: Mësuesi ndan nxënësit në grupe me nga katër anëtarë dhe shpërndan skenarët për lojën me role. Udhëzon nxënësit që brenda grupit të ndajnë rolet: një ndërmjetësues, një vëzhgues dhe dy palë në konflikt, duke sqaruar detyrat e secilit rol.

Nxënësit zhvillojnë lojën me role për 30 minuta, duke simuluar procesin e ndërmjetësimit. Mësuesi monitoron procesin dhe inkurajon përfshirjen aktive dhe interpretimin.

Reflektimi i strukturuar: Pas përfundimit të ushtrimit, mësuesi udhëheq një diskutim reflektiv, duke drejtuar pyetje për palët, ndërmjetësuesit dhe vëzhguesit mbi përjetimet, vështirësitë, cilësitë e ndërmjetësimit dhe rezultatet e arritura.

Përmbyllja dhe lidhja me jetën reale: Mësuesi nxit diskutim mbi përvojat reale të ndërmjetësimit, rolin e tij në kontekste të ndryshme kulturore dhe rëndësinë e tij në ndërtimin e paqes.

FLETË PUNE		
Lojë me role për ndërmjetësimin - 1 Një nënë dhe vajza e saj janë në konflikt për Facebook-un dhe Instagram-in. Nëna mendon se vajza po ndan shumë informacione personale në profilin e saj dhe fotografitë e saj i duken shumë provokuese. Vajza, nga ana tjetër mendon se nëna e ka gabim dhe ajo është si çdo bashkëmoshatare e saj. Ndërmjetësuesi është motra, tezja ose vëllai.	*Lojë me role për ndërmjetësimin - 2* Një vajzë është ftuar që të mësojë në shtëpinë e një nxënëseje rome. Babai i saj nuk pranon. Në të njëjtën kohë, ai nuk pranon që shoqja rome të vijë në shtëpinë e tyre. Vajza mendon që babai po tregohet i paarsyeshëm dhe paragjykues. Krahas këtyre, ajo është e detyruar të bashkëpunojë me shoqen e saj. Babai është i shqetësuar për sigurinë dhe imazhin e vajzës së tij. Ai është i mërzitur që mësuesi e ka vendosur vajzën e tij në një grup me vajzën rome. Ndërmjetësuesi është një mësues shkolle.	*Lojë me role për ndërmjetësimin - 3* Shokët e dhomës në një konvikt po grinden për pastrimin e dhomës. Një nga nxënësit mendon se shoku i dhomës nuk përfshihet mjaftueshëm në pastrimin e dhomës. Ndërmjetësuesi është një bashkëmoshatar i tyre.

TEMATIKA 3: DIALOGU NDËRKULTUROR

Veprimtari: Identitetet personale dhe sociale

Përshkrimi i veprimtarisë:

Reflektim individual: Mësuesi u kërkon nxënësve të krijojnë një hartë konceptesh me titull "Identiteti im", duke shkruar elemente që lidhen me identitetin e tyre (të paktën 15), për të nxitur vetë reflektimin.

Nxënësit identifikojnë dhe dallojnë aspektet e identitetit që lidhen me përkatësinë në grup (identiteti social) dhe ato që janë unike dhe personale (identiteti personal).

Diskutimi në grup: Nxënësit organizohen në grupe dhe diskutojnë mbi elementet e identitetit të tyre, duke bashkëpunuar për të ndërtuar përkufizime për "identitetin personal" dhe "identitetin social".

Mësuesi nxit reflektimin përmes pyetjeve mbi përjetimin e ushtrimit dhe të nxënit e nxënësve gjatë aktivitetit.

*Përmbledhja***:** Mësuesi përmbledh idetë kryesore, duke theksuar natyrën e shumëfishtë, dinamike dhe të ndikuar nga faktorë socialë të identitetit, si dhe zhvillimin e tij në kohë.

Nxënësit plotësojnë fletën e punës "Le të identifikojmë!", duke reflektuar mbi cilësitë, interesat dhe pëlqimet personale, duke respektuar kufijtë e privatësisë.

FLETË PUNE

LE TË IDENTIFIKOJMË

Udhëzime: Ky është aktiviteti "mendoni-grupohuni-shkëmbeni". Jepuni nxënësve 10 minuta për të plotësuar formularët e tyre personalë. Më pas, kërkojuni atyre të kthehen te personi ngjitur dhe për 5 minuta të ndjekin radhën për të ndarë aspektet e identitetit të tyre personal. Nëse koha ua lejon, çiftet mund të rrotullohen një herë ose dy herë për të mundësuar ndarjen me anëtarë të tjerë të grupit.



Veprimtari: Kultura dhe dialogu ndërkulturor

Përshkrimi i veprimtarisë:

Punë në grupe: Mësuesi e nis veprimtarinë duke i ndarë nxënësit në grupe dhe duke i udhëzuar të ndajnë historinë e emrit të tyre (origjinën, kuptimin dhe përvojat personale që lidhen me të), me synim nxitjen e reflektimit mbi identitetin individual dhe përvojat personale.

Çdo grup përzgjedh një histori dhe e prezanton atë përmes një shfaqjeje jo verbale, duke zhvilluar aftësitë shprehëse dhe bashkëpunuese.

Mësuesi nxit diskutim në grup mbi kuptimin e kulturës dhe udhëzon nxënësit të ndërtojnë një hartë konceptesh, duke identifikuar elemente të dukshme dhe të padukshme të saj.

Nxënësit hartojnë një përkufizim për "kulturën", ndërsa mësuesi e zgjeron diskutimin duke e lidhur kulturën me grupe dhe kontekste të ndryshme shoqërore (familje, shkollë, komunitet, interesa të përbashkëta).

Prezantimi i modelit të ajsbergut të kulturës: Mësuesi prezanton konceptin e "ajsbergut të kulturës", duke shpjeguar dallimin mes elementeve të dukshme dhe atyre më të thella dhe simbolike.

Nxënësit identifikojnë aspekte të dukshme dhe të padukshme të kulturës dhe diskutojnë situata ndërkulturore, duke reflektuar mbi dallimet, sfidat dhe përfitimet e bashkëjetesës dhe dialogut ndërkulturor.

Përmbyllja: Mësuesi përmbledh duke theksuar natyrën dinamike të kulturës, diversitetin brenda dhe ndërmjet grupeve, si dhe prezanton konceptin e dialogut ndërkulturor si proces i hapur dhe respektues për të kuptuar tjetrin.

Veprimtari: Qartësimi i vlerave

Përshkrimi i veprimtarisë:

Diskutim: Mësuesi prezanton fillimisht konceptin e vlerave.

Vlerat janë një pjesë e rëndësishme e kulturës. Vlerat janë ide dhe parime që një individ i konsideron të rëndësishme dhe beson tek ato. Vlerat ndikohen nga përvojat jetësore dhe nga çka mësohet nga prindërit dhe familja, shokët dhe bashkëmoshatarët, shkolla, letërsia dhe media e shumë të tjera. Të gjithë njerëzit jetojnë sipas vlerave të caktuara, pavarësisht nëse janë ose jo të vetëdijshëm për to. Në të vërtetë, vlerat orientojnë dhe drejtojnë jetën tonë, formësojnë zgjedhjet dhe sjelljet tona, mbështetin mënyrën se si komunikojmë, ndikojnë te reagimet tona ndaj konfliktit, dhe orientojnë qasjet tona ndaj ndërtimit të paqes. Vlerat mund të ndryshojnë ndërmjet kulturave dhe ndërmjet individëve. Disa vlera janë themele të domosdoshme për paqen e qëndrueshme: këto vlera universale duhet të mësohen dhe përvetësohen. Rëndësia relative që njerëzit dhe grupet u caktojnë vlerave të caktuara në krahasim me të tjerat mund të çojë te përplasja e vlerave. Prandaj, vetëdijesimi për vlerat e dikujt është i rëndësishëm për përpjekjet në zgjidhjen e konfliktit dhe ndërtimin e paqes.

Punë individuale: Mësuesi shpërndan fletën e punës 1 dhe u kërkon nxënësve të përzgjedhin individualisht 10 vlera dhe sjellje që pasqyrojnë më mirë atë që ata vlerësojnë më shumë.

Diskutimi në çifte: Nxënësit punojnë në çifte dhe ndajnë me njëri-tjetrin vlerat e përzgjedhura, duke diskutuar se si këto ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Punë individuale: Mësuesi shpërndan fletën e punës 2. Nxënësit identifikojnë individualisht tri vlerat më të rëndësishme dhe reflektojnë mbi to duke iu përgjigjur pyetjeve përkatëse.
Analiza në çifte: Nxënësit rikthehen në çifte dhe diskutojnë mbi vlerat kryesore, besimet që lidhen me to dhe sjelljet që ato nxisin.
Mësuesi prezanton klasifikimin e vlerave duke dhënë shembuj dhe duke sqaruar dallimet.
Reflektimi dhe lidhja me jetën shoqërore: Nxënësit diskutojnë rëndësinë e këtyre llojeve të vlerave në jetën personale dhe në proceset e ndërtimit të paqes.

FLETË PUNE 1

Ushtrimi: Vlerat dhe sjelljet

Arritjet	Qartësia	Efektiviteti	Miqësia	Të dëgjuarit	Respekti
Përshtatshmëria	Këshillimi/ mentorimi	Entuziazmi/ Qëndrimi pozitiv	Brezat e ardhshëm	Bërja e ndryshimit	Shpërblimi
Ambicia	Kujdesi	Sipërmarrja	Bujaria	Të qenit i hapur	Ndërmarrja e rrezikut
Vënia në ekuilibër e punës dhe jetës	Kompetenca	Ndërgjegjësimi për mjedisin	Shëndeti	Durimi	Siguria
Të qenit i pëlqyer	Zgjidhja e konfliktit	Etika	Përulësia	Këmbëngulja	Vetëdisiplina
Të qenit i ndershëm	Të nxënit e vazhdueshëm	Përsosmëria	Humori/zbavitja	Përmbushja personale	Puna në ekip
Përkujdesja	Paqja	Ndershmëria	Pavarësia	Rritja personale	Besimi
Dhembshuria	Krijimtaria	Qëndrueshmëria financiare	Integriteti	Rritja profesionale	Pasuria
Përfshirja e komunitetit	Dialogu	Falja	Siguria në punë	Njohja	Mirëqenia

Angazhimi	Të qenit i qetë me pasigurinë	Liria	Drejtimi	Besueshmëria	Mençuria

FLETË PUNE 2

Tre vlerat e mia më të rëndësishme	Besimet e mia rreth këtyre vlerave	Si i shpreh këto vlera në veprim

Veprimtari: Të dëgjuarit aktiv dhe empatik

Përshkrimi i veprimtarisë:

Organizimi dhe prezantimi i metodës: Mësuesi organizon klasën në formë rrethi dhe shpjegon metodën "Akuariumi", sipas së cilës grupi ulet në formën e një rrethi të madh dhe vëzhgon ndërveprimin që ndodh në formën e lojës me role në qendër të tij.

Mësuesi përzgjedh dy nxënës vullnetarë dhe u jep udhëzime për rolet e tyre. Ndërkohë, nxënësit e tjerë punojnë në çifte për të identifikuar karakteristikat e një dëgjuesi të mirë.

Lojë me role: Nxënësit zhvillojnë dialogun në dy raunde:

- ✓ në raundin e parë demonstrohet dëgjimi joefektiv;
- ✓ në raundin e dytë praktikohet dëgjimi aktiv dhe empatik.

Udhëzime për dialogun: Tregojuni nxënësve se ata do të zhvillojnë një dialog në formën e lojës me role në dy raunde. Një person do të jetë folësi dhe tjetri dëgjuesi. Folësi duhet të flasë për një situatë (imagjinare) që e ka shqetësuar gjatë ditës së tij (ngelja në provim, një zënkë me një shok, etj.). Ai duhet të përpiqet të komunikojë atë që ndodhi dhe se si u ndje lidhur me të. Ai duhet t'i tregojë këto ndjenja edhe përmes veprimeve.

Në raundin 1, teksa folësi flet, dëgjuesi duhet të bëjë shumë gjëra që tregojnë se ai/ ajo nuk po dëgjon në të vërtetë (duket i shpërqendruar, ndërpret, i humbasin sinjalet emocionale, duke mos e kuptuar se si ndihet tjetri, edhe pse ka shenja që e tregojnë, nuk bën pyetje, zgjedh vetëm një fjalë që thuhet dhe më pas del nga tema me vërejtjet e tij, vepron në mënyrë gjykuese ndaj asaj që thotë personi etj.).

Në raundin 2, folësi do të provojë sërish të shprehë atë që tha edhe më parë, dhe këtë herë dëgjuesi do të demonstrojë aftësitë e të dëgjuarit aktiv dhe empatik, (vendosja e kontaktit me sy, nuk ndërpret, tund kokën ose pohon me fjalë se po ndjek atë që po thuhet, bën pyetje jo gjykuese për qartësim, rikujton fjalët ose ndjenjat e personit tjetër, etj.). Nxënësit e tjerë do të dëgjojnë dy shokët që flasin dhe më pas do t'iu kërkohet të ndajnë atë që vëzhguan.
Nxënësit vëzhgues analizojnë të dy situatat, krahasojnë mënyrat e dëgjimit dhe marrin shënime mbi dallimet:

- ✓ Çfarë vutë re në këtë ndërveprim?
- ✓ Çfarë po bënte Nxënësi A dhe Nxënësi B?
- ✓ Cilat sjellje të Nxënësit B treguan se ai nuk po dëgjonte?
- ✓ Si do të ndiheshit nëse në këtë situatë ju do të ishit Nxënësi A?

*Diskutimi i udhëhequr***:** Mësuesi nxit diskutim në grup, ku nxënësit ndajnë vëzhgimet dhe përvojat e tyre, identifikojnë gabimet dhe përpilojnë këshilla për dëgjimin aktiv.
Reflektimi dhe lidhja me jetën reale: Nxënësit reflektojnë mbi rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe empatik në situata reale komunikimi dhe në zgjidhjen e konflikteve.

Këshilla për të dëgjuarit aktiv dhe empatik

Dëgjoni: Kur dëgjoni, komentet dhe opinionet mbajini për vete, pra përqendrohuni që të jini të heshtur dhe të vëmendshëm teksa personi tjetër flet;

Kontakti me sy: Mbani kontakt të përshtatshëm me sy dhe kushtojini vëmendje kur e shihni drejtpërdrejt në sy;

Dëgjoni më shumë: Ndaloni përpara se të thoni diçka pas folësit. Lërini atij mundësinë të vazhdojë nëse nuk ka përfunduar.

Tregoni se po dëgjoni: Komunikoni në mënyrë jo verbale duke nxitur gjuhën e trupit (si tundja e kokës), duke qenë të vetëdijshëm për sinjalet e tyre jo verbale.

Perifrazoni: Kur personi tjetër ndalon së foluri, përpiquni të perifrazoni me fjalët kyç që ai përdori dhe kontrolloni nëse e keni kuptuar qartë atë që ai tha.

Pyetni: Bëni pyetje ndjekëse për të treguar se po bëni një përpjekje të vërtetë për të kuptuar atë që ai po ndan ose përjeton.

Dëgjoni nga pikëpamja e tyre: Merrni parasysh pikëpamjen e tyre, pra dëgjoni për të kuptuar plotësisht se çfarë po thotë personi tjetër për përvojën e tij në vend që të përgatiteni për të dhënë përgjigjen tuaj;

Tregoni empati: Identifikoni dhe pasqyroni ndjenjat e folësit. Për shembull, mund të thoni: "Dukesh i mërzitur", ose "Dukesh i shqetësuar". Pyetni veten: "Si do të ndihesha në këtë situatë?

Veprimtari: Stereotipet, paragjykimi dhe diskriminimi

Përshkrimi i veprimtarisë:

Reflektim individual: Mësuesi prezanton disa stereotipa të zakonshëm dhe jep fraza të papërfunduara për t'i nxitur nxënësit të plotësojnë me përgjigje spontane, duke i orientuar drejt ndërgjegjësimit fillestar. (p.sh., "Të gjithë të moshuarit harrojnë"), dhe më pas jep disa fraza fillestare për të inkurajuar nxënësit të mendojnë dhe të japin përgjigje stereotipike (p.sh., "Vajzat janë…", "Djemtë janë…", "Refugjatët janë…").

Nxënësit plotësojnë frazat dhe reflektojnë mbi përgjigjet e tyre, duke analizuar përmbajtjen dhe ndjenjat që lidhen me to.

Diskutimi në grupe të vogla: Mësuesi organizon diskutim në çifte ose grupe të vogla, ku nxënësit ndajnë përgjigjet, reflektojnë dhe diskutojnë pse këto pohime nuk janë të vlefshme për të gjithë.

Ndërtimi i hartës së koncepteve: Nxënësit krijojnë një hartë konceptesh me konceptin "stereotip" në qendër, duke shtuar shembuj, ndjenja dhe ide që lidhen me të, dhe e pasurojnë atë përmes bashkëpunimit me një shok/shoqe.

Mësuesi mbledh dhe organizon idetë kryesore në një hartë të përbashkët dhe udhëzon nxënësit të formulojnë një përkufizim për stereotipin, duke ndërtuar një përkufizim të përbashkët në klasë.

Mësuesi prezanton lidhjen midis stereotipave, paragjykimeve dhe diskriminimit, si dhe koncepte të lidhura me to, si etnocentrizmi, duke i ilustruar me shembuj konkretë.

Nxënësit identifikojnë mënyra për të parandaluar dhe kapërcyer stereotipat dhe paragjykimet, duke propozuar strategji konkrete.

Përmbledhja dhe reflektimi: Mësuesi përmbledh pikat kryesore dhe nxënësit reflektojnë mbi rëndësinë e vetëdijesimit dhe ndikimin e stereotipave në marrëdhëniet shoqërore.

Veprimtari: Intoleranca, racizmi dhe ksenofobia

Përshkrimi i veprimtarisë:

Nxitja e diskutimit përmes imazheve: Mësuesi prezanton imazhe që ilustrojnë sjellje jo tolerante dhe ekstremiste. Ai nxit nxënësit t'i vëzhgojnë dhe të shprehin mendimet e tyre mbi situatat e paraqitura, si dhe të reflektojnë mbi ndjesitë e personave të përfshirë. Nxënësit reflektojnë mbi arsyet pse lind intoleranca dhe diskutojnë perceptimet e tyre mbi situatat e paraqitura.

Konceptualizimi i termave kryesorë: Mësuesi angazhon nxënësit që të përpiqen të përcaktojnë termat kyç: intoleranca dhe ksenofobia. Më pas prezanton dhe sqaron konceptet duke i lidhur me shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

Intoleranca është mungesa e vullnetit për të pranuar besimet/mënyrat e jetesës/sjelljet që janë të ndryshme nga tonat. Ksenofobia është frika dhe urrejtja ndaj të panjohurve dhe të huajve, ose ndaj gjithçkaje që është e panjohur ose e huaj.

Nxënësit ndërtojnë një hartë konceptesh me temë "Shkaqet e intolerancës", duke identifikuar faktorë si stereotipat, paragjykimet, media, edukimi dhe historia.

Mësuesi shpjegon konceptet e stereotipit dhe paragjykimit, ndërsa nxënësit japin shembuj nga përvoja e tyre dhe i analizojnë ato në kontekst shoqëror. Nxënësit nxiten të reflektojnë mbi përvojat personale me intolerancën dhe paragjykimin, duke diskutuar ndjenjat dhe reagimet e tyre në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

Diskutimi i strukturuar në rreth: Mësuesi organizon një rreth diskutimi, ku nxënësit ndajnë mendimet dhe emocionet duke respektuar radhën e fjalës, duke nxitur dëgjimin dhe empatinë.

Përmbledhja dhe orientimi drejt veprimit: Mësuesi përmbledh pikat kryesore, duke theksuar ndikimin negativ të intolerancës dhe rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe veprimit për ta parandaluar atë, si dhe lidh aktivitetin me hapat e ardhshëm për zhvillimin e strategjive.

Tematika 4: Mobilizimi i të rinjve për ndërtimin e paqes

Veprimtari: Ngjitja e shkallës

Përshkrimi i veprimtarisë:

Aktivizimi i njohurive: Veprimtaria fillon me aktivizimin e njohurive paraprake, ku mësuesi u drejton nxënësve pyetjen: "Çfarë kuptoni me pjesëmarrjen e të rinjve?" dhe i fton të ndajnë shembuj nga përvoja e tyre personale. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe reflektojnë mbi situata konkrete nga jeta e përditshme.

Prezantimi i konceptit (shkalla e pjesëmarrjes): Më pas, mësuesi prezanton konceptin e "shkallës së pjesëmarrjes së të rinjve", duke shpjeguar nivelet e ndryshme dhe kuptimin e tyre. Diskutimi që pason ndihmon nxënësit të kuptojnë dallimet mes niveleve dhe të reflektojnë mbi mënyrat se si realizohet pjesëmarrja në kontekste të ndryshme.

Lojë me role: Në vijim zhvillohet loja me role. Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i cakton secilit grup një nivel të pjesëmarrjes. Nxënësit përgatisin dhe interpretojnë situata të shkurtra (2–3 minuta) që ilustrojnë nivelin e caktuar. Pas çdo prezantimi, mësuesi nxit diskutim, ndërsa nxënësit komentojnë dhe analizojnë interpretimet e njëri-tjetrit.

Identifikimi i përvojave personale: Veprimtaria vijon me lidhjen e konceptit me përvojat personale. Nxënësit punojnë fillimisht në çifte për të identifikuar shembuj nga jeta e tyre që lidhen me nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, dhe më pas i ndajnë këto shembuj në grupe të vogla.

Analiza e pengesave dhe faktorëve mundësues: Në fazën tjetër, nxënësit analizojnë faktorët që ndikojnë në pjesëmarrje. Nën drejtimin e mësuesit, ata identifikojnë pengesat dhe faktorët mundësues, duke i shprehur idetë në pusulla ngjitëse dhe duke i organizuar në kategori përkatëse.

Organizimi dhe klasifikimi: Më tej, mësuesi udhëzon nxënësit të klasifikojnë këta faktorë në dy grupe: ata që janë nën kontrollin e tyre dhe ata që janë jashtë kontrollit. Nxënësit diskutojnë dhe riorganizojnë idetë, duke reflektuar mbi mundësitë konkrete për veprim dhe mënyrat për të kapërcyer pengesat.

*Diskutim përmbyllës dhe reflektim***:** Në përfundim, zhvillohet një diskutim reflektues, ku mësuesi drejton pyetje mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve dhe mënyrat për ta rritur atë. Nxënësit reflektojnë mbi rolin e tyre në komunitet dhe propozojnë mënyra konkrete për të qenë më aktivë dhe të angazhuar.

Nxënësit kuptojnë nivelet e pjesëmarrjes, analizojnë faktorët që ndikojnë në të dhe zhvillojnë aftësi për bashkëpunim, organizim dhe angazhim aktiv në komunitet.

Veprimtari: Gazetaria për paqen

Përshkrimi i veprimtarisë:

Ky aktivitet i ndihmon të rinjtë të mësojnë dhe të shqyrtojnë në mënyrë kritike historitë e konfliktit dhe paqes në burimet mediatike. Ajo i ndihmon ata të mendojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse për mënyrën e krijimit dhe përdorimit të mesazheve në shoqëri. Nxënësit vëzhgojnë dhe analizojnë zhvillime aktuale sociale dhe politike në rajon; njohin rolin e medias në procesin e ndërtimit të marrëdhënieve të mira.

Hyrja dhe aktivizimi i njohurive: Mësuesi nis veprimtarinë duke i përfshirë nxënësit në një diskutim të shkurtër për median. Nxit diskutimin përmes pyetjeve, si: "A mendoni se media ndikon në mënyrën si njerëzit e shohin konfliktin?" ose "A mund ta nxisë media konfliktin apo ta zbusë atë?". Mësuesi prezanton shkurtimisht konceptin e gazetarisë për paqen, duke theksuar se ajo synon të paraqesë konfliktet në mënyrë të balancuar dhe të nxisë zgjidhje, jo përshkallëzim.

Nxënësit ndajnë mendimet dhe përvojat e tyre mbi rolin e medias. Ata aktivizojnë njohuritë paraprake dhe fillojnë të kuptojnë se si informacioni mediatik mund të ndikojë në perceptimet dhe qëndrimet.

Organizimi i punës në grupe: Mësuesi ndan klasën në nëngrupe prej 4–5 nxënësish dhe organizon ambientin në formën e "ishujve" të punës. Çdo grup pajiset me 1–2 artikuj lajmesh (të shtypur ose online), si dhe me tabelë dhe lapustila. Mësuesi shpjegon detyrën dhe pyetjet udhëzuese që do të përdoren për analizë.

Nxënësit organizohen në grupe, ndajnë rolet (p.sh. lexues, shënues etj.) dhe njihen me materialin që do të analizojnë.

Analiza kritike e artikujve: Mësuesi udhëzon grupet të analizojnë artikujt duke përdorur pyetjet orientuese (palët e konfliktit, balanca e zërave, prania e paragjykimeve, mundësitë për zgjidhje etj.). Ai lëviz mes grupeve, mbështet diskutimin, bën pyetje nxitëse dhe ndihmon nxënësit të thellojnë analizën. Nxënësit lexojnë artikujt dhe diskutojnë në grup. Ata identifikojnë:

- ✓ sa dhe cilat palë paraqiten,
- ✓ nëse ka barazi në përfaqësim,
- ✓ nëse gjuha nxit konflikt ose paqe,
- ✓ nëse ofrohen zgjidhje ose alternativa.

Nxënësit shkruajnë gjetjet dhe reflektimet në tabelë, duke strukturuar mendimet e tyre në mënyrë të qartë.

Prezantimi i gjetjeve: Mësuesi fton çdo grup të prezantojë gjetjet kryesore dhe paralelisht sintetizon idetë kryesore në një fletë të përbashkët, duke evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet mes artikujve. Secili grup prezanton analizën e tij, argumenton qëndrimet dhe dëgjon grupet e tjera. Nxënësit krahasojnë perspektivat dhe pasurojnë kuptimin e tyre për mënyrën si media trajton konfliktin.
Reflektimi dhe diskutimi i thelluar: Mësuesi udhëheq një diskutim reflektiv me të gjithë klasën duke u fokusuar në:

- ✓ rolin e medias në përshkallëzimin ose zbutjen e konfliktit,
- ✓ rolin e gazetarisë në promovimin e paqes dhe në raportimin e përgjegjshëm të konflikteve,
- ✓ rolin e qytetarëve si konsumatorë dhe krijues të përmbajtjes.

Nxënësit nxiten të mendojnë në mënyrë kritike për mesazhet mediatike dhe orientohen drejt ideve për promovimin e paqes dhe solidaritetit. Nxënësit reflektojnë mbi atë që kanë mësuar, japin mendime dhe propozojnë ide konkrete se si mund të ndikojnë pozitivisht në përmbajtjet që konsumojnë dhe prodhojnë (sidomos në rrjetet sociale).
Përmbyllja dhe nxjerrja e përfundimeve: Mësuesi përmbledh idetë kryesore të veprimtarisë, duke theksuar rëndësinë e të menduarit kritik dhe përgjegjësisë në përdorimin e medias. Nxënësit nxjerrin përfundimet kryesore dhe reflektojnë se si do ta përdorin këtë njohuri në situata reale.

Veprimtari: Çfarë është advokimi?
Përshkrimi i veprimtarisë:

Hyrja dhe rrahja e mendimeve: Mësuesi hap veprimtarinë duke prezantuar temën dhe duke bërë një pyetje nxitëse: "Çfarë kuptoni me fjalën advokim?". Ai/ajo i fton nxënësit të japin ide lirshëm, pa i gjykuar përgjigjet. Ndërkohë, shkruan në tabelë fjalët dhe shprehjet kyçe që përmenden (p.sh. mbrojtje e një çështjeje, ndikim, ndryshim etj.). Nxënësit japin ide, shembuj ose përkufizime sipas kuptimit të tyre. Ata kontribuojnë aktivisht dhe fillojnë të ndërtojnë një kuptim të përbashkët të konceptit.
Sqarimi i konceptit të advokimit: Pas rrahjes së mendimeve, mësuesi përmbledh idetë kryesore dhe jep një përkufizim të qartë: *Advokimi është procesi i ndikimit për të mbrojtur një çështje, për të ndryshuar politika, qëndrime ose praktika në shoqëri.* Mësuesi jep disa shembuj konkretë

(p.sh. nisma rinore për mbrojtjen e mjedisit, fushata kundër gjuhës së urrejtjes, iniciativa për paqe në rajon). Nxënësit dëgjojnë, krahasojnë idetë e tyre me përkufizimin dhe bëjnë pyetje për të sqaruar konceptin.

Ndarja e përvojave: Mësuesi pyet nxënësit nëse kanë marrë pjesë ndonjëherë në aktivitete që lidhen me advokimin (fushata, nisma komunitare, aktivitete në shkollë). Ai/ajo nxit ndarjen e përvojave dhe thekson praktikat pozitive, sidomos ato që lidhen me ndërtimin e paqes. Nxënësit ndajnë përvojat e tyre personale ose shembuj që njohin. Ata reflektojnë mbi rolin e tyre si individë aktivë në komunitet.

Organizimi i punës në grupe: Mësuesi ndan klasën në tre grupe dhe u shpërndan kartat me "Hapat e procesit të advokimit", të cilat janë të përziera (jo në rend kronologjik). Ai/ajo shpjegon detyrën: grupet duhet të vendosin hapat në rendin që u duket logjik dhe të diskutojnë kuptimin e secilit hap.

Nxënësit organizohen në grupe, lexojnë kartat dhe fillojnë diskutimin për të kuptuar dhe renditur hapat e procesit.

Renditja dhe analiza e hapave: Mësuesi monitoron punën e grupeve, bën pyetje udhëzuese (p.sh. "Cili mendoni se është hapi i parë?", "Pse është i rëndësishëm ky hap?") dhe i ndihmon nxënësit të mendojnë në mënyrë logjike dhe sistematike. Nxënësit diskutojnë në grup dhe rendisin hapat e advokimit, si:

- ✓ përcaktimi i çështjes,
- ✓ vendosja e qëllimit dhe objektivave,
- ✓ identifikimi i audiencës,
- ✓ ndërtimi i mbështetjes,
- ✓ zhvillimi i mesazhit,
- ✓ zgjedhja e kanaleve,
- ✓ hartimi i planit të zbatimit.

Ata argumentojnë zgjedhjet e tyre dhe reflektojnë mbi domethënien praktike të secilit hap.

Prezantimi dhe diskutimi në grup të madh: Mësuesi fton grupet të prezantojnë renditjen e tyre. Ai/ajo moderon diskutimin, krahason përgjigjet dhe udhëheq klasën drejt renditjes së saktë të hapave. Gjithashtu, jep sqarime shtesë dhe lidh teorinë me praktikën.

Nxënësit prezantojnë punën e grupit, dëgjojnë grupet e tjera dhe marrin pjesë në diskutim për të arritur një kuptim të përbashkët të procesit të advokimit.

Reflektimi mbi rolin e advokimit në ndërtimin e paqes: Mësuesi drejton një diskutim reflektiv:

- ✓ Si mund të përdoret advokimi për të parandaluar konfliktet?
- ✓ Si mund të kontribuojnë të rinjtë në ndërtimin e paqes përmes advokimit?

Mësuesi evidenton se advokimi është një mjet i rëndësishëm për ndryshim social dhe për promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit. Nxënësit japin ide dhe shembuj konkretë, duke kuptuar potencialin e advokimit si instrument për paqe dhe ndryshim pozitiv.

Përmbyllja: Mësuesi përmbledh pikat kryesore të veprimtarisë dhe thekson rëndësinë e planifikimit të mirë dhe angazhimit qytetar. Nxënësit nxjerrin përfundimet kryesore dhe reflektojnë mbi atë që kanë mësuar.

8. PRODUKTI FINAL I MODULIT

Në përfundim të modulit, nxënësit realizojnë një **fushatë advokimi për ndërtimin e paqes**, përmes një procesi të qartë planifikimi, zbatimi dhe reflektimi.
Produkti final organizohet në këto faza kryesore:

a) Identifikimi i çështjes

Nxënësit, në grupe, identifikojnë një situatë reale që mund të lidhet me:

- ✓ konfliktet në shkollë (p.sh. bullizmi, përjashtimi social etj.);
- ✓ mungesa e dialogut ndërkulturor;
- ✓ stereotipet, paragjykimet ose gjuhën e urrejtjes;
- ✓ sfida të bashkëjetesës në komunitet.

b) Analiza e situatës

Nxënësit analizojnë çështjen duke përdorur mjetet e mësuara në modul (p.sh. "pema e konfliktit"), duke identifikuar:

- ✓ shkaqet dhe faktorët nxitës;
- ✓ aktorët e përfshirë;
- ✓ pasojat e situatës;
- ✓ mundësitë për ndërhyrje.

c) Planifikimi i ndërhyrjes

Çdo grup harton një plan të thjeshtë veprimi që përfshin:

- ✓ qëllimin dhe objektivat e nismës;
- ✓ mesazhin kryesor që do të përcillet;
- ✓ aktivitetet konkrete (p.sh. fushatë, debat, sesion informues);
- ✓ ndarjen e roleve brenda grupit;
- ✓ mjetet dhe burimet që do të përdoren.

d) Realizimi i produktit/nismës

Nxënësit zbatojnë planin përmes një ose disa formave konkrete, si p.sh.:

- ✓ fushatë ndërgjegjësuese në shkollë (postera, video, prezantime);
- ✓ organizim debati ose forum diskutimi me bashkëmoshatarët;
- ✓ gazeta e paqes, ku trajtohen tema të konfliktit dhe dialogut.

e) Prezantimi publik

Grupet prezantojnë produktin dhe procesin e tyre para klasës, shkollës ose komunitetit, duke shpjeguar:

- ✓ problemin e trajtuar;
- ✓ zgjidhjen e propozuar;
- ✓ ndikimin e arritur ose të pritshëm.

Produkti final zhvillohet kryesisht në grup, duke nxitur bashkëpunimin, ndarjen e roleve dhe përgjegjësinë e përbashkët, ndërsa kontributi individual pasqyrohet përmes reflektimit, pjesëmarrjes dhe rolit të secilit në realizimin e projektit.

Vlerësimi i produktit final

Vlerësimi i produktit final bazohet në produktin final dhe në procesin e realizimit të tij. Vlerësimi i produktit final mbështetet në kritere të qarta, si p.sh.:

- ✓ kuptimi dhe zbatimi i koncepteve të modulit (konflikti, paqja, dialogu etj.);
- ✓ aftësia për të analizuar dhe adresuar një problem real;
- ✓ krijimtaria dhe cilësia e zgjidhjes së propozuar;
- ✓ bashkëpunimi dhe ndarja e roleve në grup;
- ✓ aftësia për të reflektuar mbi procesin dhe rezultatet.

Në vëmendje!

Shënim 1: Nëse moduli zgjidhet nga nxënësit për t'u zhvilluar në kurrikulën me zgjedhje, vlerësimi kryhet sipas të njëjtave procedura si për lëndët e tjera.

Shënim 2: Nëse moduli zgjidhet nga nxënësit për t'u zhvilluar në kurrikulën në bazë shkolle vlerësohet vetëm mbi bazën e kryerjes së modulit (pa notë).

9. BURIME MBËSHTETËSE:

- Edukimi i bashkëmoshatarëve rinorë për ndërtimin e paqes dhe transformimin e konfliktit, UNFPA, 2021: Manual për trajnuesit rinorë për paqen
- **https://albania.unfpa.org/sq/publications/manual-p%C3%ABr-trajnuesit-rinor%C3%AB-p%C3%ABr-paqen**